



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 571, datë 6.10.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË 35 NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT
NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE
RRËSHEN, BASHKIA MIRDITË, NË KUADËR TË MARRËVESHJES
SË GRANTIT TË LIDHUR NDËRMJET AGJENCISË SË ZHVILLIMIT
AUSTRIAK (ADA) DHE MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN,
PËR PROJEKTIN “PËRGJIGJE NDAJ TËRMETEVE NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 129 087 000 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të 35 njësive individuale të banimit brenda zonës së re për zhvillim, njësia administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë, në zbatim të marrëveshjes së grantit të lidhur, ndërmjet Agjencisë së Zhvillimit Austriak (ADA) dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, për projektin “Përgjigje ndaj tërmeteve në Shqipëri”.
2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 129 087 000 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 4677/1
DATË 2.10. 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT
TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN
E REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

